

ERJON PAPAGJONI**MARRËDHËNIA JURIDIKE E KOMUNITETEVE FETARE
ME SHTETIN SHQIPTAR – STATUTET 1949-1950****Abstrakt:**

Ndërhyrja e shtetit komunist në “qeverisjen” e komuniteteve fetare përmes statuteve të tyre jo vetëm që cenoi integritetin juridik të tyre, por në një shumicë nenesh këto statute shprehnin brendi politike në përputhje me regjimin. Ligji i linte shtetit diskrecionin të ndihmonte ose jo komunitetet fetare, gjithë pjesa tjetër e ligjit ishte thelbësisht një listë detyrimesh që komunitetet fetare kishin ndaj shtetit. Në skajin e kundërt me modelin e një shteti teokratik (që synon shkrirjen në një të shtetit me fenë) regjimi i PPSH, ndonëse shpallte ngado laicizmin e tij, nuk ndahej aspak nga feja, por praktikisht shrinte pushtetin e tij mbi çdo aspekt me rëndësi në veprimtarinë e komuniteteve fetare. Mbishtresa politike në statute e heq mbulesën formale dhe në nene të caktuara dorashka e angazhimit politik u është përplasur në fytyrë komuniteteve fetare, mjaft të përmendet se në detyrën e edukimit të besimtarëve dhe klerit duhej të mbahej parasysh edhe qëllimi “që të luftoheshin besëtytnitë e vjetra”.

Në një kuptim, i përligjur historikisht, statutet qenë shprehje e një kompromisi politik me situatën ku gjendeshin komunitetet fetare, përfshi edhe segmentet e devotshme proqeveritare brenda tyre, duke përcjellë në trajtë juridike statuoare një farë garancie ndaj shtetit komunist, për të ndjekur vijën e tij politike. Ky shtet i ri tashmë kërkonte prej komuniteteve fetare një angazhim të hapur politik, brohorima entuziaste dhe duartrokitje deri në raskapitje, nga të gjithë.

Fjalë kyçe:

Shteti, feja, komunizmi, shekullarizimi, statuti, diktatura

Raporti i ri i komuniteteve fetare me shtetin

Feja, përveçse botëkuptim, frymë, ndjeshmëri, faktor kohezioni social, psikologjik e deri atribut etnik e kombëtar¹, është edhe një realitet historik i prekshëm, pra një dukuri historike që mund të shqyrtohet në optika të ndryshme. Në kushtet e Shqipërisë, duke qenë se feja nuk unifikohet me kombin dhe anasjelltas, siç ngjet në rastet e disa kombeve të tjerë në periudha të caktuara historike, ka lindur nevoja e një dallimi të prerë midis kombit dhe fesë, kombit si tërësi etnohistorike e pandarë dhe pjesëve të caktuara të tij, që praktikojnë këtë apo atë besim. Në ecurinë e shekujve është krijuar vetiu, si rrethanë historike specifike dhe si nevojë e brendshme mbijetese, një simbiozë dhe natyrë e *dyfishtë* e qenësisë etnike e historike: përkatësia kombëtare dhe përkatësia fetare, ku e para e dominon dhe e kushtëzon të dytën në funksion të kohezionit.

Për cilindo studiues, vendas a të huaj, që synon të studiojë harkun dyshekullor Jakobino-Bolshevik 1789-1989 (nga rënia e Bastijës deri të rënia e Murit të Berlinit) pra, një kohë ideologjish të mëdha që provokuan edhe rebelimet e mëdha të skllavit/vartësit ndaj padronit pronar (çifligar a industrialist) dhe ndaj padronit Zot, ngjarjet shqiptare të periudhës 1944-1967, për shkak të natyrës ekstreme të goditjes ndaj fesë, që kulmoi në vitin 1967, besoj se meritojnë një trajtim të thelluar. Fushata e pashembullt që regjimi komunist ndërmoi ndaj fesë, klerit dhe institucioneve të saj legjitime e me tradita mijëra vjeçare solli, përpos trysnisë psikologjike dhe frikës, një rrënim thuajse tërësor të çdo veprimtarie fetare, të çdo mendësie të lidhur me të, të çdo gjurme institucionale.²

Me ardhjen e PKSH në pushtet fill pas çlirimit të vendit (e fshehur pas Frontit Demokratik), u pasua me likuidimin e çdo opozite të mundshme, duke kryer reprezalje ndaj gjithë segmenteve politike dhe

¹ Erich From, *Të kesh apo të jesh*, Tiranë: Phoenix, 2001, f. 40-44, 105, 133, 158-163.

² Neni 37 i Kushtetutës së vitit 1976 shprehej se “Shteti nuk njeh asnjë fe dhe përkrah e zhvillon propagandën ateiste për të rrënjësuar te njerëzit botëkuptimin materialist shkencor”. Ndërsa në nenin 55 të saj shprehja e vullnetit politik të regjimit në ndalimin e fesë dhe institucioneve fetare, i konsideronte tashmë si armike të hapura të ndërtimit socialist të vendit dhe edukimit të njeriut të ri dhe brumosjen e tij me ideologjinë marksiste-leniniste, duke i njëjtësuar dhe cilësuar ato dhe veprimtaritë e tyre si “armiçësore”.

elementëve antikomunistë. Vërshimi i një lumi akuzash, që nga bashkëpunimi me pushtuesit e gjer te sabotazhi, diversioni, organizimi i veprimtarive për rrëzimin me dhunë të pushtetit të ri etj., e bëri përfundimisht të papërbalueshëm presionin që ushtrohej mbi komunitetet fetare. Mbetej që ato të përshtateshin me rolin që u kishte projektuar pushteti i ri, përputhur synimeve që ai kishte. Si kudo gjetkë, komunistët po e riformatonin besimin ndaj Zotit në besimin e ri ndaj Partisë dhe Udhëheqësit, një “Mesia i ri” që do sillte mrekullinë. Kështu, “Zbritja e Zotit në tokë” paraqitej si vetëdije shkencore, si qytetërim dhe emancipim. “Feja dhe komunizmi ishin të papërputhshëm si në teori, ashtu dhe në praktikë”.³ Përkushtimin e besimtarëve “barinjve” të fesë po e zhvendoste cak pas caku drejt të vetmes forcë politike e ideologjike udhëheqëse në vitin 1948, Partisë Komuniste dhe “bariut” të saj, Enver Hoxhës, që i printe grigjës sociale duke i premtuar “Edenin” aq shumë të propaganduar - barazinë edhe në tokë, për të gjithë, bashkë me “lugën e florinjte”. Kjo “parajsë e re” ishte tunduese posaçërisht për rininë, si kontingjenti i “njeriut të ri” që kish zënë të fabrikohej sakaq.

Më 14 mars 1946, Asambleja Kushtetuese miratoi Kushtetutën, e cila ishte “një dokument hibrid, me përbërës ligjorë dhe konstitucionalë të traditës së mëparshme juridike shqiptare dhe asaj borgjeze e po ashtu, sigurisht, edhe të asaj sovjetike e jugosllave.”⁴ Në nenin 16 të saj shkruhej: “Të gjithë shtetasvet u garantohet liria e ndërgjegjës dhe e besimit. Kisha është e ndarë nga shteti. Komunitetet fetare janë të lira në çështjet e tyre të besimit si edhe në ushtrimin dhe praktikimin e jashtëm të tyre. Shteti munt të ndihmojë materialisht komunitetet fetare”.⁵ Po këto përcaktime gjenden edhe pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 1950, neni 18.⁶ Pas shqyrtimit në Këshillin e Ministrave, ishte Presidiumi i Kuvendit Popullor ai që miratoi më 26 nëntor 1949 Ligjin për Komunitetet Fetare, i

³ Nikolai Bukharin & Evgeny Preobrazhenski, *The ABC of Communism*, Ann Arbor: Michigan University Press, 1966, 247.

⁴ *Studim mbi të drejtat e pronësisë të komuniteteve fetare në Shqipëri*, botuar nga Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (A.L.T.R.I) në kuadër të projektit me temë: “Një studim gjithëpërfshirës mbi të drejtat e pronësisë të komuniteteve fetare në Shqipëri”, financuar nga Canada Fund for Local Initiatives, Tiranë: 2016.

⁵ *Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë*, Asambleja Kushtetuese, Tiranë: Shtypshkronja Bashkimi, 1946, Kapitulli III, neni 16, 15 mars 1946.

⁶ *Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë*, Tiranë: 5 korrik 1950, Kreu III, “Të drejtat dhe detyrat e shtetasve”, neni 18.

cili, krahasuar me ligjin e vitit 1929 të qeverisë monarkiste,⁷ qartësisht ofronte një marrëdhënie më imponuese në raportet e shtetit me këto komunitete. Zyra e Kryeministrisë ia përcolli ligjin Komuniteteve, të shoqëruar me një letër shpjeguese nga ana e zëvendëskryeministrit Tuk Jakova, por pa iu lënë atyre një kohë të mjaftueshme reflektimi. Afati 3-mujor që përcaktonte neni 35 i dekretligjit për paraqitjen e statuteve të reja, në mungesë të një modeli të studiuar e të hollësishëm për nga nocionet juridike e kushtetuese që trajtojnë një fushë kaq delikate të legjislationit, shkaktoi një nxitim të ankthshëm që u ndie kudo nëpër korridoret e selive qendrore të komuniteteve fetare.

Tanimë prej komuniteteve, qysh në misionin, raportet me besimtarët dhe shërbesat që kryenin, përveç bindjes ndaj urdhrave të Zotit, kërkohej bindje, besnikëri dhe përkushtim ndaj atdheut, ndaj “demokracisë popullore” (nënkupto: shtetin e diktaturës së proletariatit), ndaj rendit kushtetues, interesave të popullit dhe unitetit të tij. Theksimi i tepruar i konceptit të sovranitetit të plotë të shtetit, në vendet totalitare, zakonisht nuk parathotë asgjë të mirë. Sikundër nënvizonte ministri i Drejtësisë, Manol Konomi në artikullin e tij “Shteti dhe kisha” të botuar në gazetën “Zëri i Popullit”, datë 27 nëntor 1949, “kisha nuk duhet të radhitet në krahun e kampit armik dhe luftënxitës”. Për të garantuar këtë, “sovraniteti i plotë i shtetit” do të ishte një kusht *sine qua non* për komunitetet fetare, të cilat qenë të detyruara ta zbatonin me përpikëri, përfshi gjithë ligjet e shtetit, ndryshe do të humbnin personalitetin e tyre juridik dhe vetë ekzistencën institucionale përballë shtetit.”⁸

Përveç rrënimit ekonomik që entet fetare kishin pësuar gjatë Luftës II Botërore, rrethanat që favorizuan gjunjëzimin e klerit ndaj pushtetit tëri, ndërlihdeshin qartësisht me pasojat e reformës agrare dhe shtetëzimet që kishin ndodhur ndërkohë mbi pasuritë e tyre, dhe që praktikisht iu pamundësonin këtyre komuniteteve çdo mundësi rimëkëmbjeje jashtë dhe pavarësisht financimit nga buxheti i shtetit.⁹Në

⁷ “Dekret-Ligjë mbi formimin e Komuniteteve Fetare”, botuar në *Gazetën Zyrtare*, Tiranë, 1 shkurt 1930.

⁸ Manol Konomi, “Shteti dhe kisha”, *Zëri i Popullit*, Tiranë, 27 nëntor 1949.

⁹ Nëse këqyret struktura financiare e kishës ortodokse me 4 peshkopata, 14 zëvendës mitropolitanë, që përfshinin më shumë se 40 manastire dhe 500 kisha, rezulton se nga 684 700 franga ari që kryepeshkopi i kishës ortodokse i paraqiti qeverisë si kërkesë për buxhetimin e saj, ajo kishte mundësi të përmbushte nga burimet e veta vetëm 84

Kushtetutën e vitit 1946, në nenin 16, thuhej se “*Shteti mund të ndihmojë materialisht komunitetet fetare*”.¹⁰ Kjo ishte formalisht e njëjllotë për të katër komunitetet fetare: myslimanët, bektashinjtë, ortodoksët dhe katolikët, por nëse te bektashinjtë pati fillimisht një farë “dorëzënieje” për shkak të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të klerit të lartë në Luftën Nacionalçlirimtare përkrah Frontit të udhëhequr nga Partia Komuniste, përkundrazi, me komunitetin katolik qëndrimi ishte shumë më i vrazhdët. Kjo u manifestua te konfiskimet e aseteve jetike si dhe te ndëshkimet shembullore ndaj klerikëve, që kishin mbajtur një qëndrim të shprehur antikomunist apo qoftë edhe jo bashkëpunues gjatë viteve të luftës.¹¹

Megjithë natyrën shtrënguese të dekretligjit të 26 nëntorit 1949 mbi komunitetet fetare, gjithsesi duke ndjekur modelin e të ashtuquajturave “demokraci popullore” sipas tipologjisë staliniste sovjetike, bëhej kujdes që të mos prekeshin hapur ndjenjat fetare të njerëzve, duke ditur se një fenomen i tillë sillte me vete shqetësime e trazira. Ndërkohë, as një vit më parë, më 10 dhjetor 1948, nga Asambleja e Kombeve të Bashkuara ishte nënshkruar *Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut*. Sipas studiuesit të njohur të së drejtës ndërkombëtare Humphrey JP, kjo deklaratë vlerësohet si përbërës themelor i kuadrit ligjor të Kombeve të Bashkuara, e cila përfshin në formë të sintetizuar gjithë traditën zakonore të kombeve që konvergonin në këto parime.¹² Ndonëse jo nënshkrues të saj, impakti i deklaratës u shpreh deri diku, të paktën në teknikën legjislative të formulimit të ligjeve, edhe në shtetet e Bllokut Lindor.

Edhe pse Shqipëria nuk ishte nënshkruese e kësaj Deklarate as më 1949 dhe as më vonë, gjithsesi në dekretligjin e datës 26 nëntor 1949 mbi komunitetet fetare, formalisht ajo pati përkitje. Në këtë projektligj theksohej garancia kushtetuese për lirinë e ushtrimit të fesë duke

700 franga ari. *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AMPJ*), Viti (më tej: V.), 1945, Dosja (më tej: D.) 4, fl. 16.

¹⁰ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.), Kryeministria (490), Viti (më tej: V.), 1946, Dosja (më tej: D.) 51, fl. 7.

¹¹ Imzot Zef Simoni, “Persekutimi i kishës katolike në Shqipëri nga 1944-1990”, kumtesë e mbajtur në *Krishtërimi ndër shqiptarë*, Simpozium Ndërkombëtar, Tiranë, 16-19 nëntor 1999, Shkodër: 2000, f. 370; *AQSh*, F. Kryeministria (490), V. 1951, D. 1898, fl. 10, 16, 19; *po aty*, F. Kryeministria (490), V. 1953, D. 1171, fl. 12, 13, 14, 79.

¹² John P. Humphrey, “The Universal Declaration of Human Rights: Its History, Impact and Juridical Character”, in Bertie G. Ramcharan (ed), *Human Rights: Thirty Years After the Universal Declaration*, The Hague; Boston: Martinus Nijhoff, Hingham, 1979, f. 21, 37.

paraparë, madje, sanksione ndaj çdo dhunimi e ndalimi, ndaj çdo veprimtarie a ideje që nxiste dasitë dhe urrejtjen fetare. Njësoj si në ligjin rumun, i cili shërbeu edhe si modeli bazë për hartimin e ligjit shqiptar, neni 3 i tij ndalonte përdorimin e fesë për qëllime politike dhe krijimin e organizatave politike mbi baza fetare.¹³

Statutet ose heqja e “mandatit të pavarësisë”

Jo vetëm për të siguruar kontroll, por edhe për t’iu përshtatur nga pikëpamja ligjore statutet e enteve fetare dhe veprimtarinë e tyre sipas karakterit dhe brendisë politike të pushtetit të ri, përmes 37 neneve të ligjit 773/16.01.1950, u synua pikërisht një përputhshmëri midis tyre. Në thelb, ajo nënkuptonte heqjen e “mandatit të pavarësisë” së këtyre enteve, zhveshjen e tyre nga specifikat identitare që i dallonin. Përshtatja e statuteve me karakterin e regjimit të ri nënkuptonte, më së pari, implementimin e vullnetit politik të shtetit nëpërmjet formave të ndryshme të imponimit që ky ligj ia lejonte plotësisht. Së dyti, dukuria e natyrës kushtetuese të marrëdhënies shtet-komunitet fetar u reflektua qysh në procedurën e zgjedhjes së drejtuesve të tyre, ku emërimi ose jo i personelit të rangjeve të larta fetare duhej të merrte patjetër miratimin e qeverisë dhe të gëzonte besimin e saj, përndryshe nuk mund të ushtronin dot detyrën e tyre, edhe nëse zgjidheshin nga forumet përkatëse (neni 13).

Në veprimtaritë e veta ekonomike, entet fetare duhej të siguronin më parë miratimin nga hallkat shtetërore përkatëse, gjë e cila i futi ato në hullitë e një procesi burokratik e asfiksues, që ngadalësonte e pengonte kryerjen në kohë, cilësi e përmasë të tyre, gjer dhe në heqjen dorë dhe në dështim.

Duke qenë se feja ndahej prerazi nga shteti, nga ana tjetër ishte po shteti që shtrinte këmbët e veta mbi komunitetet fetare. Përmes trysnisë së tij ideologjike e doktrinore ai përpiqej, madje, të kryente gjithnjë e më shpesh operacione zhvendosjeje të hapësirës së besimit dhe të ndërjegjes fetare të njerëzve në favor të botëkuptimit marksist dhe gjithë koncepteve që ai përmbante. Alternativës fetare të ekzistencës së Zotit, të fuqive të tjera mistike, të padukshme, të panjohura e të mbinatyrshme i kundërvuhej alternativa e doktrinës komuniste e paraqitur si e *drejtë absolute*. Pushteti hyjnor zëvendësohej nga fuqia e “proletariatit të

¹³ Shih Dekret nr. 743, “Mbi Komunitetet Fetare”, datë 26.11.1949, aprovuar me ligjin 773, “Mbi komunitetet fetare”, 16. 01. 1950.

bashkuar të të gjithë vendeve”, që merrte pjesë në lëvizjen revolucionare dhe që bëhej “zot” i fateve të tyre, falë kjo sigurisht, udhëheqjes së pagabueshme të partisë?!... “Grigja” e besimtarëve kthehej në “grigjën e bindur sociale”.¹⁴ Këto slogane zëvendësuan sentencat dhe urdhëresat e shenjta. Duke suprimuar Zotin si të “drejtë hyjnore”, që konvertohej në të “drejtë njerëzore”, shteti komunist suprimoi çdo alternativë të së drejtës duke e njëjtësuar gjithçka tek ajo çka vetë shteti njihte si “të drejtë”.¹⁵

●
Për t’i orientuar komunitetet fetare në përpilimin e statuteve të tyre, qeveria u dërgoi një qarkore, e cila mbyllej me rikujtesën se, në rast dështimi të respektimit të afatit që parashikohej për paraqitjen e statuteve të reja (neni 35), natyrisht përputhur normave dhe frymës së ligjit të ri, Kuvendi kishte të drejtën që t’i suprimonte institucionet fetare dhe veprimtarinë e tyre të mëtejshme ta konsideronte të paligjshme.¹⁶ Të zgjedhurit e drejtuesve të lartë duhej të çoheshin për miratim në Këshillin e Ministrave, ndërsa të zgjedhurit e hallkave të ndërvarura e dytësore duhet të merrnin miratimin e organeve të pushtetit lokal. Në një qarkore të dytë drejtuar organeve të larta të komuniteteve fetare, theksohej rishtazi, detyrimi për miratimin e shpejtë të statuteve dhe organeve të zgjedhura klerikale nga forumet e pushtetit qendror dhe vendor sipas hierarkisë.¹⁷

I vetmi që bëri një rezistencë serioze ishte komuniteti katolik. Sipas tyre, kërkesat e ligjit të paraqitur ishin shkelje e qenësisë së kësaj kishe, e konceptuar pikërisht si pjesë e një organizmi unik e universal, siç që Kisha Katolike botërore nën hierarkinë dhe juridiksionin e Selisë së Shenjtë. Struktura *ekleziste* e saj e konsideronte Papën si “gjqqtarin kryesor për çështjet e rëndësishme, përgjegjës për organizimin ekleziastik dhe të drejtës kanonike, arbitër suprem i disiplinës së Kishës. Ai mbante *plenitudo protestatis* mbi kishën dhe mbikëqyrte zgjedhjen e peshkopëve, i vendoste apo i hiqte ata”.¹⁸ Ndodhi një përplasje e madhe, e cila shkaktoi për të dyja palët, jo pak pasoja e shqetësime. Qeveria kërkoi bisedime me klerin katolik të përfaqësuar nga meshtari Bernard Shllaku,

¹⁴ Immanuel Kant, *Kritika e gjykimit*, Tiranë: Plejad, 2004, f. 188.

¹⁵ Luan Omari, Aurela Anastasi, *E drejta kushtetuese*, Tiranë: Shtëpia botuese ABC, 2008.

¹⁶ *AQSH*, F. 882, V. 1949, D. 1, fl. 7.

¹⁷ *Po aty*, F. 536, V. 1949, D. 244, fl. 7.

¹⁸ Aurela Anastasi. *Historia e institucioneve*, Tiranë: SHBLU, 1998, f. 229.

për rregullimin përfundimtar të statutit sipas kërkesave të ligjit të ri. Sakaq, në tubimin e 56 klerikëve të besimeve të ndryshme, i mbajtur në Shkodër në nëntor të vitit 1950, kisha katolike e refuzoi kërkesën e qeverisë për mos ta pranuar Selinë e Shenjtë si superiore të saj, çka, sipas meshtarit plak e besnik, imzot Shllakut, “ishte e papranueshme për katolikët”.¹⁹ “Na nuk aprovojmë as Projekt, as Statut, - thuhej në shkresën e Asamblesë së Përgjithshme të Klerit Katolik, - ku shkëputemi prej Vatikanit dhe shkelen Dogmat e Fesë dhe të Kishës Katolike”.²⁰ Dështimi i negociatave e çoi pushtetin në përdorimin e gjuhës së forcës duke arrestuar përfaqësuesit e guximshëm të kishës që nuk toleronin, si at Sirdanin, internimin e dom Zef Gilës, at Ferdinand Palit dhe at Viktor Volajt. Negociatat u drejtuan më pas nga dom Zef Bici dhe dom Mark Dushi, të cilët i paraqitën qeverisë tri drafte, të tria shumë pranë konceptit unitar të kishës katolike dhe “afër Romës”.²¹ Bisedimet u zgjatën rreth gjashtë muaj, por asnjë dakortësi nuk po shfaqej midis palëve për pranimin e skemës së sugjeruar.²² Opsioni qeveritar shënonte shkelje të të drejtave juridike, të cilat buronin vetiu nga mënyra e organizimit dhe funksionimit të hierarkisë eprorë kishtarë. Situata u rëndua së tepërmi kur refuzimi nga ana e Selisë së Shenjtë dhe vetë Kishës Katolike u duk i pakthyeshem, çka rezultoi me pezullimin e negociatave.²³

Neni 17 ua ndalonte tashmë komuniteteve fetare hapjen e shkollave të arsimit të përgjithshëm. Neni 18 i vendoste në një gjendje censure preventive, pasi i detyronte t’i dorëzonin paraprakisht Kryesisë së Këshillit të Ministrave letrat pastorale, qarkoret dhe çdo material tjetër që kërkonin të botonin për publikun dhe besimtarët. Edukimi dhe organizimi i fëmijëve dhe të rinjve... bëhet vetëm nën kujdesin e veçantë të shtetit (neni 23/3). Spitalet, jetimoret, dhe çdo institut tjetër i kujdesit në pronësi dhe administrim të komuniteteve fetare, shtetëzoheshin pa

¹⁹ AQSH, F. 890, V. 1950, D. 2133, fl. 8/9.

²⁰ At Konrad Gjolaj, *Çinarët*, Shkodër: 1996, f. 126

²¹ At Zef Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue*, “”, vëll. II, Tiranë: Hylli i Dritës, 1997, f. 33.

²² AQSH, F. 890, V. 1950, D. 2133, fl. 34.

²³ Imzot Zef Simoni, “Persekutimi i kishës katolike në Shqipëri nga 1944-1990”, kumtesë e mbajtur në *Krishtërimi ndër shqiptarë, Simpozium ndërkombëtar, Tiranë, 16-19 Nëntor 1999*, Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë, Shkodër: 2000, f. 375-376.

kundërshpërblim (neni 24). “Pasurija e komuniteteve fetare të çdukura ose të atyre që ju hiqet njohja i kalon Shtetit” (neni 29).

Si shpata e Demokleut mbi kryet e komuniteteve fetare, qëndronte neni 7, i cili, nga interpretimi tërësor i tekstit të ligjit, i jepte qeverisë jo vetëm pushtetin që t’ia refuzonte njohjen e personalitetit juridik një komuniteti fetar të caktuar, por edhe ta revokonte atë në çdo kohë që e vlerësonte si të arsyeshme. Nga analiza e tekstit, duket se synimi thelbësor i hartuesve të ligjit ishte dobësimi gradual, deri në nënshtrimin total të komuniteteve fetare ndaj regjimit të ri në fuqi.

Statuti i Komunitetit Mysliman

Bashkësia islame në Shqipëri ishte komuniteti më i madh fetar. Përveç bektashinjve, që përbënin komunitet më vete, të gjitha tarikatet e tjera islame që vepronin në Shqipëri, si Halveti*, vetëm ky kishte administratë. Tarikatet e tjerë, meqenëse ishin shumë të vegjël, nuk kishin as administratë dhe as këshill, por vetëm “kryeprija”.

Statuti i Komunitetit Mysliman shqiptar u miratua nga Këshilli i Përgjithshëm i këtij komuniteti dhe mori formën e vet përfundimtare gjatë konferencës së jashtëzakonshme, përputhur parimeve të përgjithshme dhe skemës së sugjeruar nga qeveria. Efektivisht statuti hyri në fuqi me Dekretin Nr. 1064, dt. 04.05.1950, të Presidiumit të Kuvendit Popullor. Lënda përbëhej nga hyrja dhe 11 kapituj. Krahas praktikimit lirisht të së drejtës së ushtrimit të fesë te besimtarët, në nenin 2 ishin futur edhe paragrafë me brendi politike si edukimi, nxitja dhe jetësimi i ndjenjës patriotike, i dashurisë për atdheun, i besnikërisë ndaj Republikës, i devotshmërisë ndaj pushtetit popullor. Neni 66 përcaktonte se çdo të premtë dhe ditë Bajrami hytbet [predikimet dhe lutjet] për shtetin dhe për Ushtrinë Kombëtare bëhen në gjuhën shqipe. Referuar nenit 66, ndryshimet në statut bëheshin me jo më pak se dy të tretat e votave të Këshillit të Përgjithshëm. Nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, Komuniteti Mysliman siguronte aksesin e domosdoshëm në marrëdhëniet specifike me qeverinë, rregulloret dhe udhëzimet e saj, si dhe aspektet ekonomike e financiare, legjislacionin etj.

* Tarikati Halveti me gjithë nëntarikatet a degët halvetiane: Akbashi, Karabashi, Xhelveti, Hajati, Gjylsheni e Melami; tarikatet e tjerë si: Kadiri, Tixhani, Rufai dhe Sa’adi, përfshiheshin në Komunitetin Mysliman.

Këshilli i Përgjithshëm i këtij komuniteti ishte forumi drejtues më i lartë, i cili përgjigjej për mbarëvajtjen e gjithë veprimtarisë së komunitetit, shqyrtonte, miratonte dhe kontrollonte efektshmërinë e bilancit ekonomik, të ardhurat dhe pasuritë, ndiqte në rrugë vertikale drejtimin e gjithë hallkave vartëse nëpër myftinitë dhe xhamitë e saj, hartonte rregulloret dhe shpërndante qarkoret me karakter të ndryshëm, kujdesej për asetet dhe pasuritë e paluajtshme të komunitetit, hartonte programe dhe objektiva për edukimin fetar të besimtarëve, ndiqte kalendarin e datave të shenjta e të shënuara. Në kapitullin e dytë, në nenet 6, 7 dhe 8, flitej për strukturën organizative të komunitetit, ku përfshihej mënyra e funksionimit dhe veprimi të Këshillit të Përgjithshëm, të drejtat dhe detyrat e tij, udhëheqja dhe personeli ndihmës, përcaktimi i postit të kryetarit, kompetencat, më pas postet e katër kryemyftinjve, delegatët e zgjedhur një për një për çdo prefekturë me mandate 5-vjeçare. Një kapitull i kushtohet drejtorisë së Komunitetit Mysliman me identifikimet gjegjëse të funksioneve, detyrave, përgjegjësive dhe ushtrimit të udhëheqësisë.

Hallkë e rëndësishme në zinxhirin e drejtimit të komunitetit, e cila rregullonte dhe legjitimonte proceset ekzekutive të drejtorisë ishte Komiteti i Përhershëm me kryetarin, Myftiun e madh, drejtorin e Vakëfeve dhe një të zgjedhur nga besimtarët me mandat trevjeçar, i cili duhej të kishte njohuri të mira fetare.²⁴ Duke qenë se gjuha shqipe ishte gjuha e lejuar për përdorim, në funksionet e Komitetit të Përhershëm përfshiheshin përgatitja dhe botimi i gjithë literaturës fetare, librat, fletushkat, qarkoret, revistat fetare, ato letrare, hartimi i *Hytbet*-eve dhe lutjeve të ndryshme, që shërbenin në procesin e mbarëvajtjes së ritualeve dhe nevojave shpirtërore të besimtarëve.

Hierarkisë së drejtimit i shtohet edhe hallka e *Drejtorit të Vakëfeve*, kompetencat e të cilit, tok me të drejtat dhe përgjegjësitë parashtroheshin në nenet 19-24.²⁵ Ai ishte përfaqësuesi më i lartë i administratës, kontrollonte bilancet dhe aktivitetin financiar dhe bënte lidhjet midis komunitetit dhe qeverisë.

Miradministrimit të të ardhurave, mirëmbajtjes së aseteve e pasurive të ndryshme i përgjigjet në mënyrë të detajuar kapitulli 8, në nëntë nene të tij. Dhuratat dhe burimet e tjera financiare të huaja, jashtë Shqipërisë, qenë të ndaluara. Komuniteti ishte i detyruar që të dhënat e

²⁴ *AQSH*, F. 890, V. 1950, D. 850. 3, fl. 18.

²⁵ *Po aty*, fl. 20.

regjistrin të llogarive t'ia përcillte qeverisë për kontroll. Kjo praktikë e fuste atë përfundimisht në një marrëdhënie të shprehur varësie nga shteti, e manifestuar në mënyrën se si regjistri i llogarive morri dokordësinë e qeverisë ose, në të kundërtën, kërkoheshin shpjegime për mosrakordimin e bilanceve.²⁶ Kjo nënkuptonte në thelb mbajtjen nën kontrollin e drejtpërdrejtë të saj dhe presion të vazhdueshëm.

Një nga strukturat bazë të organizimit të komunitetit mysliman ishin *myftinitë*. Përveç katër myftinive të mëdha, në myftinitë e qyteteve dhe fshatrave që përfshiheshin në zonat e vendit, rolin prijës e kryente myftiu i zonës përkatëse. Drejtuesit e myftinive të mëdha zgjidheshin nga Këshilli i Përgjithshëm i Komunitetit Mysliman dhe miratoheshin nga Këshilli Ministerial. Përkatësisht rasteve të parashikuara në statut në nenin 36, kryemyftinjtë, myftinjtë dhe zëvendësmyftinjtë mund të shkarkoheshin nga detyra për shkelje të ndryshme, tejkalim kompetencash, gabime apo faje me vendim të posaçëm të Këshillit të Përgjithshëm.

Kapitulli i shtatë i kushtohet organizimit të administratës së komunitetit, i nëpunësve dhe zyrave të saj si struktura sa hierarkike, aq dhe vetëvepruese. Në nenet 53 dhe 54, lidhur me xhamitë dhe mesxhidet e qyteteve dhe fshatrave, krahas të tjerave përcaktoheshin edhe detyrat e *muezinëve*, *imamëve* dhe *vaizëve*, pjesë e stafit të xhamive. Pagat e personelit siguroheshin pjesërisht nga të ardhurat e komunitetit.²⁷

Nenet 55-59 i kushtohen *Medresesë së Madhe*, strukturës së saj, mënyrës së funksionimit dhe administrimit. Një nga pikat e rëndësishme që trajtohet në statut që edhe prania e vëllazërive myslimane, sikurse genë vëllazëritë *Kadri*, *Tixhai*, *Rifai*, *Sadi*.²⁸

Shumësia e tarikateve myslimanë në Shqipëri lidhej pikërisht me specifikat identifikuese rajonale, ato spirituale, me trashëgimitë etnokulturore dhe shanset e impaktit me të, si dhe ofrimit të risive konceptuale të doktrinës islame nga njerëz të ditur të këtij religjioni. Ky

²⁶ *Po aty*, fl. 21.

²⁷ Personeli i selisë qendrore të Komunitetit Mysliman së bashku me Medresenë e Përgjithshme në vitin 1950 rezultonte të kishte 40 vetë; personeli i myftinisë së Vlorës kishte 57 klerikë, ajo e Korçës 50, e Gjirokastrës 20, e Kukësit 56. Vetëm personeli i Tiranës në gjithë shkallën e vet hierarkike numëronte 1008 klerikë, kurse myftinia e Peshkopisë kishte të regjistruar në kontot e saj aktive 158 persona. *Po aty*, F. 890, V. 1950, D. 850, fl. 3.

²⁸ Alberto Ventura, *L'esoterismo islamico*, Roma: Atanòr, 1981.

pluralitet qasjesh brenda të njëjtës doktrinë dhe frymëzim religjioz përbën, në fakt, përveçse një pasuri spirituale, edhe një shumësi mënyrash konceptimi, aplikimesh ritualistike, formash organizimi e qenësie, çka nënkuptojnë si tërësi, po ashtu edhe fizionomi identitare të ndryshme të myslimanizmit shqiptar. Secila nga vëllazëritë e mësipërme zgjidhte një përfaqësues të vetin, që siguronte marrëdhënien e brendshme e “natyrore” midis vëllazërisë me komunitetin në përgjithësi. Pas miratimit të çdo kandidature nga kryetari i komunitetit, ajo shkonte për miratim detyrimisht edhe te Këshilli i Ministrave.

Statuti i komunitetit bektashi

Ky statut u miratua më 4 maj 1950 në Kuvendin Popullor me dekretin nr. 1066.²⁹ Ai kishte tetë kapituj dhe një hyrje. Nga një vështrim sintetik përmbajtja e statutit shkonte përputhur parimeve fetare myslimane, por të detajuara dhe nën frymën e doktrinës që ky komunitet kishte përqaftuar dhe aplikonte, duke ruajtur në karakterin e tij një liri më të shprehur të individit në kryerjen e ritualit fetar dhe pjesëmarrjes së tij në bashkësi, sikundër një angazhim më të drejtpërdrejtë në çështjet civile. Duhet shtuar se, për shkak edhe të pjesëmarrjes së gjerë të besimtarëve bektashi në Luftën Nacionalçlirimtare, ky komunitet ishte ndoshta më i parapëlqyeri nga drejtuesit e shtetit komunist.

Ndër kategoritë kryesore që përbëjnë hierarkinë brenda këtij komuniteti janë: ashikët, myhibët, dervishët, myxherët, halifët, baba-të dhe gjer te shkalla e lartë e hierarkisë si Gjyshi dhe Kryegjyshi.³⁰ Bektashizmi si tarikat fetar mysliman ka një strukturë hierarkike të veçantë, ashtu sikundër edhe pjesa rituale e kryerjes së shërbesave të ndryshme fetare, e procesioneve, lutjeve, praktikave që janë të mëvetshme. Për kushtet historike të persekutimeve, ngulmimeve dhe shpërndarjes së tyre në botë, Shqipëria ishte bërë vendi kryesor i kësaj vëllazërie. Kleri i lartë i komunitetit duhej të ishte me kombësi dhe shtetësi shqiptare, gjuha e aplikuar në gjithë ritualin dhe lutjet ishte shqipja, por në raste të veçanta përfshiheshin edhe gjuhë të tjera (neni 3), pasi komuniteti nuk ishte përjashtimisht shqiptar. Në strukturën e

²⁹ *Gazeta zyrtare*, nr. 43, Tiranë, 14 korrik 1950, f. 3-14.

³⁰ Metin Izeti, *Tarikati Bektashian*, Tetovë: Çabej, 2001, f. 124–126.

komunitetit bektashi në Shqipëri përfshiheshin gjashtë gjyshata, ndërsa katër të tjera ishin jashtë territorit të saj.*

Është i pranuar fakti se bektashinjtë shqiptarë, në thelbin më të thellë të tyre, kishin prirje ekumenike: pranim, pajtim dhe vëllazërim me shqiptarët e krishterë. Në një farë caku e kuptimi, ata u bënë “protektorë” të zakoneve, dokeve e traditave etnologjike shqiptare duke e pranuar dhe “tretur” fenë myslimane të ardhur nga Perandoria Osmane në një formë, si të thuash, origjinale, të “ndërmjetësuar”. Ata “e ndalonin plotësisht poligaminë dhe zakonet e shturura, - specifikon Akademiku Beqir Meta, - hidhte poshtë praktikat fetare strikte dhe, më në fund, nuk lejonte në asnjë mënyrë ndërhyrjen e fesë në çështjet shtetërore, si dhe kufizimin e të drejtave të gruas brenda shoqërisë”.³¹ Kjo prirje e brendshme e bektashizmit vinte qysh në fillimet e përhapjes së këtij sektit ndër shqiptarë, dhe siç shprehet me të drejtë Akademiku Pëllumb Xhufi: “Sinkretizmi e heterodoksizmi i mishëruar në tekstin *bektashi*, bëri që ky, gjatë periudhës së lëvizjes kombëtare në Shqipëri, të merrte një rol përbashkues e të identifikohet me këtë lëvizje.”³²

Veçoritë e bektashizmit vihen në dukje, madje, edhe nga një raport i Misionit Amerikan në Tiranë dërguar Departamentit të Shtetit të SHBA,³³ ku, ndër të tjera, nënvizohet se bektashinjtë qenë një sekt gjysmëmysliman, i pavarur, të cilët mbështesnin qeverinë.

Në brendinë teologjike të doktrinës që aplikohet, e reflektuar edhe në statutin e këtij komuniteti, ka jo pak qasje filozofike të një universalizmi dhe humanizmi me impakte të fuqishme në sjelljen e

* Nga gjyshatat brenda kufijve të Shqipërisë qenë: Gjyshata e Krujës, e Elbasanit, e Korçës, e Gjirokastrës, e Skraparit, e Vlorës, ndërsa nga gjyshatat jashtë kufijve të Shqipërisë bënin pjesë: Gjyshata e Tetovës, e Gjakovës, e Detroitit, e Stambollit.

³¹ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në shqipëri (1912-1924)*, QSA, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2013, f. 191.

³² Pëllumb Xhufi, *Árbërit e Jonit. Vlora, Delvina e Janina në shekujt XV-XVII*, QSA, Instituti i Historisë, Tiranë: Onufri, 2016, f. 1163.

³³ “Tolerantë dhe të prirë për thjeshtësi, ata respektojnë gruan (të cilat janë të lira të shkojnë në teqe apo manastire); atje predikohet dashuria vëllazërore, barazia sociale dhe dinjiteti i punës. Ata e shohin Zotin si autoritet madhor, por askush nuk është i perfeksionuar. Lirisht ata pranojnë kristianët, myslimanët dhe urdhrat e tjerë fetarë..., pa u kërkuar të heqin dorë nga besimet e tyre të hershme. Bektashinjtë, tashmë përbëjnë një pluralitet ndërmjet shqiptarëve”. *National Archives and National Record Administration* (më tej: NARA), “Final report of Special Mission at Tirana”, Section VI International Relation, f. 1-17. Cituar sipas: Hamit Kaba, *Shqipëria dhe të Mëdhenjtë. Nga Lufta e Dytë Botërore në Luftën e Ftohtë*, Tiranë: Klean, 2015, f. 300.

besimtarit në raport me shoqërinë dhe botën, duke bartur gjer dhe mendësi laiciste e shekullariste.³⁴ E afërt me *Halveti-të* është edhe vëllazëria e *Rufai-ve*, e quajtur ndryshe *Tarikati Rufai*, të cilët e përdorin muzikën, këngën dhe vallen me natyrë rrethrotulluese brenda një individi, të njohur ndryshe edhe si *dervishë*, falë të cilës mbërrihet në harmoni, paqe dhe prekje mistike të transhendencës hyjnore.³⁵

Një pjesë e klerit të lartë të komunitetit bektashian, për shkak të qëndrimit ndaj PKSHE dhe qeverisë së saj, pati kundërshti të cilat arritën gjer në zgjidhje ekstreme, kur Kryegjyshi Abaz Ilmi Dede, sipas versionit të gazetës “Bashkimi” datë 20 mars 1947³⁶, vrau në zyrat e këtij komuniteti më 18 maj 1947, Mustafa Xhanin. Në fakt, ngjarja ka mbetur ende e paqartë dhe me disa versione.³⁷ Shkaku, sipas shtypit komunist, që qëndrimi “reformator” që kjo pjesë e klerit proqeveritar kishte mbajtur, i vetëquajtur si krahu “progresist”, me animet e tij të theksuara ndaj konceptit radikal të PKSHE.³⁸ Kjo u kundërshtua nga Kryegjyshi Abaz Ilmi Dede. Të ekzekutuarit Mustafa Xhani dhe baba Fejzo kërkonin “demokratizimin” e tarikatit bektashian, “demokratizim” i cili pranonte që dervishët të mbanin veshje civile dhe të martoheshin³⁹, kërkesë që vetë M. Xhani ia kishte bërë Kryegjyshit Dede.⁴⁰

PPSH e shfrytëzoi atdhetarizmin e besimtarëve bektashinj, si dhe prirjen sekulariste që bektashizmi përmbante në vetë filozofinë dhe doktrinën e tij. Po ka mundësi të kishte dhe një arsye tjetër pse ky komunitet ishte si më i preferuar prej saj. Kjo kishte të bënte me shtrirjen ndërkombëtare dhe karakterin internacional të ushtrimit të religjionit prej bektashinjve. Ndoshta përmes këtij sektit, PPSH projektonte të krijonte ura lidhëse me institucione, forume dhe asociacione me prirje të majta në vendet e Evropës Perëndimore, në SHBA e gjer në Australi.⁴¹

³⁴ H. Kaba, *Shqipëria dhe të Mëdhenjtë ...*, f. 353-356.

³⁵ Alberto Fabio Ambrosio, *Dervisci. Storia, antropologia, mistica*, Roma: Carocci, 2011, f. 64-89.

³⁶ Gazeta *Bashkimi*, Tiranë, 20 mars 1947 dhe 27 mars 1947.

³⁷ <https://gazetaimpakt/krijimi-i-komunitetit-bektashian-si-u-vrane-baba-faja-baba-fejzo-e-dede-abazi/> (Historia-Opinion, Nga Xhafer Sadiku, December 28, 2018)

³⁸ “Heroi tragjik i bektashizmit”, gazeta *Dita* (www. Gazetadita.al), 27 qershor 2016; Zenel Gjoni, “Haxhi Lleshi: Baba Fajën e vranë në zyrë”, *po aty*, 28 qershor 2016.

³⁹ Ali M. Basha, *Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri (1912-1967)*, Tiranë: 2011, f. 124.

⁴⁰ Zenel Gjoni, “Heroi tragjik i bektashinjve”, gazeta *Dita*, 27 qershor 2016.

⁴¹ “Selia e Shenjtë e Kryegjyshit Botërore, në Tiranë, - vinte në dukje studiuesi italian Giovanni Cimbalo, - për të qenë efektivisht botërore, duhej të kapërcente tre probleme

Statuti i komunitetit ortodoks

Statuti i komunitetit ortodoks u miratua nga Kongresi III i besimtarëve ortodoksë të përfaqësuar përmes institucioneve të kësaj feje, mbajtur në Tiranë, më 5 deri 10 shkurt 1950. Qysh më 20 nëntor 1945, Këshilli i Përgjithshëm (i quajtur MIKST) ra dakord që t'i vendoste marrëdhëniet me shtetin mbi “një bazë juridike të re dhe KOASH vendosi, pa shumë dilema, të pajtohej me regjimin komunist”.⁴² Paçka se nga një pjesë e klerit dhe teologëve të rinj pati ndër vite rezistencë dhe ky qëndrim do të kritikohet si nënshtrim ndaj shtetit, paçka se kisha duhej të ruante integritetin e saj, pavarësinë nga shteti dhe kërkesat e tij, ky qëllim u bë gjithnjë e më i paarritshëm në kushtet kur po shfaqeshin në mënyrë agresive rrethana dhe koniunktura politike asfiksuese. Statuti duhej të ishte shprehje e interesave, detyrimeve, të drejtave dhe gjendjes së besimtarëve ortodoksë shqiptarë të përfaqësuar përmes Kishës Autoqefale Ortodokse të Shqipërisë (KOASH) si pjesë e strukturës së kishës së përgjithshme apostolike me qendër në Stamboll.⁴³

të mëdha. I pari kishte të bënte me mungesën e një qendre të vërtetë teologjike, të aftë për përpunimin dhe thellimin e doktrinës. Shenja e dytë e dobësisë kishte të bënte me gjendjen e rëndë ekonomike të vendit, ku e kishte selinë qendra botërore. Kjo përbënte arsyen e tretë të krizës për shkak të së cilës jo vetëm pengohej hyrja e donacioneve nga jashtë, por edhe tkurreshin ndjeshëm lidhjet me komunitetet e tjera jashtë vendit. Për këtë arsye Kryegjyshi e kishte thuar se pamundur të ushtronte detyrën e tij si ndërmjetës mes komunitetit bektashian shqiptar dhe besimtarëve të tjerë të shpërndarë nëpër botë”. Giovanni Cimbalò, *Pluralizmi i besimit dhe komunitetet fetare në Shqipëri (Studime të së drejtës së Krahasuar. E drejta kishtare dhe të drejtat njerëzore. Raporti i fesë me shtetin në Shqipëri)*, Tiranë: Naimi, 2013, f. 132-133.

⁴² Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm. KOASH-i dhe regjimi diktatorial shqiptar, 1945-1967*, Tiranë: UET Press, 2017, f. 44.

⁴³ Kisha Ortodokse në botë përbëhet nga katër Patriarkana të hershme: Patriarkana Ekumenike - ajo e Kostandinopojës - e Aleksandrisë, e Antiokisë dhe e Jerusalemit (në këtë bën pjesë gjithashtu Kryepiskopata e shenjtë e Malit Sina), Kishat (patriarkanat) e Rusisë, Serbisë, Rumanisë, Bullgarisë dhe Gjeorgjisë, si dhe kishat e Qipros, Greqisë, Polonisë, Çekisë dhe Shqipërisë. Është e organizuar deri më tani në 14 Kisha Autoqefale (të vetëadministruara, nga greq. *αυτο-vetë*, *κέφαλος*-kokë). Secila Kishë drejtohet vetë, dhe njeh si kanonike Kishat që janë të organizuara saktësisht sipas kanoneve të shenjta, që kanë njohjen dhe shpalljen nga Patriarkana Ekumenike (Patriarkana e Konstandinopojës). Në tërësi për të gjithë Kishën Ortodokse në botë nuk ekziston një krye si Papa në Kishën Romano Katolike, por Kisha Ortodokse është e organizuar në juridiksione lokale që udhëhiqet nga sinodet (këshillat) e episkopëve të

Si dhe në statutet e tjerë të komuniteteve fetare, raporti shtet-fe “ngurtësohet” apo shprehet në fashën juridike që përfshihet pikërisht në nenin 14 të dekretligjit nr. 1065, datë 4 maj 1950, për komunitetet fetare në Shqipëri. Qysh në hyrje të statutit theksohej karakteri kombëtar, autoqefalia e saj, statusi si person juridik dhe institucion kishtar që respektonte dogmat dhe traditën e saj të shenjtë. Lutjet dhe rituali me pjesët përbërëse në mesha dhe ceremoni të ndryshme hartoheshin nga Drejtoria e Komunitetit Ortodoks në përputhje me synimet e kishës dhe programacionin e saj, sikundër asnjë klerik nuk mund të ushtronte funksionet e tij jashtë e përkundër hallkave miratuese të forumeve drejtuese e vendimmarrëse si kishë e pavarur (autoqefale).

Gjuha me të cilën kryheshin liturgjitë dhe ritet ishte gjuha shqipe, por sipas traditës së saj, sanksionohej edhe përdorimi i gjuhës greke në pjesë të veçanta, në shqiptime fjalësh të shenjta, thënie apostolike, pjesë të shkëputura prej dogmës dhe ungjijve, duke respektuar ritin bizantin për aq sa kjo çmohej e domosdoshme dhe pjesë e artikulimit të së shenjtës.

Forma themeltare e organizimit të Kishës Autoqefale të Shqipërisë ishte metropolia. Nga pikëpamja e hierarkisë së autoritetit dhe vendimmarrjes, organi themeltar kryesor i Kishës Autoqefale ishte *Sinodi i Shenjtë Episkopal*.⁴⁴ Ai përbëhej nga peshkopët e çdo njësie kishtarë përfaqësuese, nga dioqezat e strukturës së saj dhe drejtohej nga mitropolia qendrore me metropolitin e gjithë besimtarëve ortodoksë të Shqipërisë. Në tërësinë e udhëheqësisë së tij spirituale ky organ ruante përputhshmërinë e veprimtarisë dhe misionit të kishës me frymën e shenjtë, parimet e krishtera, dogmën dhe traditën e begatë ungjillore. *Sinodi i Shenjtë Episkopal* zgjidhte kryepeshkopin dhe peshkopët e tjerë në përputhje me rregullat e vendosura dhe legjislacionin në fuqi, duke ndjekur korpusin e principeve kanonike dhe dogmës së shenjtë.⁴⁵

vetë juridiksionit përkatës.

Shih Athanas Delikostopoulos, *Përmbledhje e Besimit Orthodhoks*, botim i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, Tiranë: 2011, f. 148, 153-154.

⁴⁴ Kisha Ortodokse organizohet dhe qeveriset nga klerikët: episkopët, priftërinjtë dhe dhjakonët. Autoriteti më i lartë administrativ i tërë Kishës Ortodokse është Sinodi Ekumenik, pra tërësia e gjithë episkopëve, që janë pasuesit e apostujve. Kishat Autoqefale janë kisha të barabarta dhe simotra me njëra-tjetrën, me parësi Patrikanën Ekumenike, që ka rol koordinues e organizativ në çështje administrative e doktrinale etj. Kisha Ortodokse ndonëse me të njëjtën doktrinë besimi, nuk është federatë kishash. Shih *po aty*, f. 31-34.

⁴⁵ Shih *po aty*.

Në vitet 1946-1949 ushtroi aktivitetin e tij religjioz, Sinodi III i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Periudha trevjeçare ishte e mbushur me praninë gjithnjë e më të drejtpërdrejtë të shtetit ndaj kishës, që u pasua me ndryshimin gradual të disa prej funksioneve jetike të saj si dhe me kufizimin e impaktit ndaj besimtarëve. Më 25 gusht 1949, kryepeshkopi i gjeratëhershëm, Kristofor Kisi, u gjend në rrethanat e një trysnie të fortë nga ana e pushtetit për mospajtimin e tij me kërkesat e qeverisë lidhur me dy çështje: e para ishte mospërfshirja e komunitetit ortodoks të SHBA, i drejtuar nga Fan Noli, në juridiksionin e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. *Tomosi patriarkanor* i autoqefalisë e shprehte qartë se Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë përbëhej nga “provincat dhe komunitetet orthodhokse që ndodhen brenda të perëndishpëtuarit Shtet Shqiptar”,⁴⁶ e dyta ishte përmbajtja e statutit, posaçërisht nenet 7 dhe 36, që bënin fjalë për të drejtën e miratimit nga ana e qeverisë të funksionarëve të lartë fetarë, rrjedhimisht cenimin e pavarësisë së kishës dhe forumeve të saj për vetëvendosje, sikundër dhe detyrimin për të paraqitur projekt-statutin e kishës në përputhje me skemën e sanksionuar nga ligji, pa të cilën ajo nuk njihej nga shteti si person juridik. Shkelja e përmbajtjes së Tomosit të Patrikanës Ekumenike krijonte kushtet e një përçarjeje të kishës, posaçërisht me koloninë shqiptare në SHBA. Pikërisht në nenin 1 dhe 9 imponohej vullneti politik i regjimit për të bërë bashkë dy komunitetet ortodokse shqiptare, atë të Shqipërisë dhe atë të SHBA, jashtë frymës dhe disiplinës kanonike.⁴⁷

Si pasojë e trysnisë dhe kërcënimit të pushtetit, Kristofor Kisi u detyrua të jepte dorëheqjen dhe vdiq më 16 qershor 1949, me shumë gjasa i helmuar. Më 25 gusht të vitit 1949 u formua Sinodi IV dhe si kryepeshkop i kësaj kishe u zgjodh Paise Vodica, një prift i ve, simpatizant i komunistëve, pjesëmarrës aktiv në Ushtrinë Nacionalçlirimtare. Vendimet e Sinodit IV nuk u njohën nga Patriarkana

⁴⁶ <http://www.forumishqiptar.com/threads/105208-Çfarë-ndodhi-me-shqiptarët-në-vitin-1967>.

⁴⁷ Kjo detyrohej nga formulimi juridik: “I gjithë kleri dhe populli orthodhoks i Republikës Popullore të Shqipërisë... përbëhet prej gjithë orthodhoksëve që banojnë brenda territorit të Republikës Popullore të Shqipërisë, si dhe prej atyre shqiptarëve orthodhoksë që banojnë jashtë atdheut”. Dhe më tutje: “Me vendim të Këshillit MIKST mund të krijohen episkopata për shqiptarët Orthodhoksë jashtë shtetit, të varura nga kisha shqiptare mëmë”.

Gazeta Zyrtare, nr. 38, 21 qershor 1950, Dekret nr. 1065, 4.05.1950, neni 1 dhe 9.

Ekumenike e Kostandinopolit, ndërsa emërimi i Paisi Vodicsës si kryepeshkop u refuzua dhe u quajt i paligjshëm, jo kanonik. Mosmarrëveshja që lindi midis KOASH dhe Patrikanës Ekumenike mori shumë shpejt konotacione politike, çka bëri që kryepeshkopi Paisi Vodica t'i drejtohej për njohje të vendimeve të Sinodit, Patrikanës së Rusisë.

Në nenin 11 të statutit qartësohej raporti i Sinodit me figurën, sjelljen, veprimtarinë dhe ushtrimin e përgjegjësive e kompetencave të peshkopëve dhe organeve të kishës në shtrirje vertikale. Në nenet 12-15 përcaktoheshin më tutje detyrime, rregulla, raste, klauzola juridike dhe të drejta mbi organizimin e mbledhjeve. Pranë Sinodit të Shenjtë emërohej edhe një sekretar që merrte pëlqimin e argjipeshkvisë.

Në nenet 16 deri në 23, statuti trajtonte figurën e peshkopëve dhe klerikëve të tjerë, përgjegjësitë, detyrat, të drejtat dhe cilësitë e tyre, sipas disa kritereve që shkonin në përputhje si me kërkesat e kishës, ashtu dhe me skemën e shtetit komunist.⁴⁸ Vetëm me autorizimin dhe miratimin e Sinodit të Shenjtë mund të emëroheshin peshkopët dhe klerikët e tjerë. Titujt dhe funksionet fetare miratoheshin po nga ai, pas propozimeve konkrete që vinin nga stafet drejtuese të dioqezave. Peshkopët duhet të kishin arsim të lartë në teologji. Çdo dioqezë kishte peshkopin e vet. Pesë nene, 24-28, rregullonin statusin e kryepeshkopit të Kishës Ortodokse Shqiptare, formatit të tij religjioz, doktrinor e moral, kompetencave dhe të drejtave. Kryepeshkopi, në mbështetje të statutit thërriste dhe drejtonte sipas rastit të paraqitur, gjithë sistemin qendror kishtar përkatësisht hallkave dhe funksioneve të parapara të hierarkisë së saj; ndiqte nga afër zbatimin e vendimeve të organeve qendrore ndaj organeve vartëse si dhe veprimtarinë kishtarë në përgjithësi; ishte përfaqësuesi zyrtar i kishës në marrëdhëniet administrative me organet ligjzbatuese të shtetit; siguronte gjithë raportet ndërvepruese me kishat e tjera simotra në botë. Si titullari më i lartë i një metropolie zgjidhej një peshkop, i cili gëzonte gjithë të drejtat, të detajuara në katër nene, 29-32, duke pasur edhe miratimin e qeverisë.

Një nga hallkat e sistemit kishtar ortodoks me rëndësi të veçantë ishin nënmitropolitë, të cilat përfshinin një numër të caktuar kishash e manastiresh (nenet 33-36). Në metropolinë qendrore, atë të Tiranë-

⁴⁸ *Po aty*, neni 16-23.

Durrësit, argjipeshkvi kishte të drejtën e emërimit të një ipeshkvi si Ikar në çdo nënmetropoli.*

Është me interes të shënohet se përgjatë veprimtarisë së saj, përfaqësia e lartë e KOASH vuri re një mangësi në statut. Dhe pikërisht paragrafi 2 i nenit 48, nuk realizonte dot një mbrojtje të gjerë e të plotë përpara organeve të drejtësisë. Për këtë shkak në janar të vitit 1960, Kuvendi Popullor e ndryshoi paragrafin 2 të dekretit duke e modifikuar nenin 49 të statutit të KOASH dhe duke i dhënë të drejtën e përfaqësimit në proceset gjyqësore, titullarëve të dioqezave të saj, si dhe të deleguarve të autorizuar prej tyre.⁴⁹

Statuti i komunitetit katolik

Ky statut mori formë ligjore me miratimin e tij nga Kuvendi Popullor i Shqipërisë me dekretin nr. 1322, datë 31 korrik 1951⁵⁰, sipas projektstatutit të miratuar nga mbledhja e Këshillit të Përgjithshëm të Kishës Katolike Shqiptare e datës 26 qershor 1951, mbajtur në Kurien e Argjipeshkvisë Metropolitane të Shkodrës, pra thuajse një muaj më parë nga shndërrimi i tij në dekretligj. Në piramidën apo strukturën organizative të Kishës Katolike të Shqipërisë përfshiheshin 6 dioqeza me njësitë e mëposhtme: argjipeshkvia e Shkodrës, e Durrësit, dioqeza e Lezhës, e Sapës, e Pultit, abacia e Nullius. Argjipeshkvi i Shkodrës ishte mitropolit. Argjipeshkvia e Durrësit drejtohej nga një argjipeshkëv, tri dioqezat, ajo e Lezhës, Sapës dhe Pultit drejtoheshin nga një ipeshkëv, ndërsa abacia e Nullius drejtohej nga një ipeshkv. Selitë e tyre ishin respektivisht: Shkodra, Durrësi, Kallmeti, Nënshati, Pulti dhe Oroshi. Argjipeshkvitë dhe dioqezat drejtoheshin nga titullarët e zgjedhur dhe të

* Në nenet 45-59 statuti përcaktonte rregullat dhe kriteret e zgjedhjes së anëtarëve të këshillave fetare të qyteteve e fshatrave, *Dhimogjerondive* dhe *Igumenive*. E drejta e zgjedhjes i takonte çdo besimtar i që plotësonte kushtet e paracaktuara dhe që ishte mbi moshën 16 vjeç. *Gjykatat fetare* qenë institucione të zbatimit dhe dhënies së të drejtës, ku nënkuptoheshin po ashtu ndëshkimet. Çdo gjykatë ishte pjesë integrale e strukturës drejtuese të dioqezës dhe përbëhej nga tre anëtarë: peshkopi si autoriteti më i lartë i saj dhe dy klerikë të zgjedhur. Vendimet e saj qenë të formës së prerë, të paapelueshme, të shoqëruara me masën ndëshkimore përkatëse.

⁴⁹ “Mbi aprovimin e ndryshimit të paragrafit të dytë të statutit të Kishës Orthodokse Autoqefale të Shqipërisë”, Dekreti nr. 3030, 12 janar 1960 në *AQSH*, F. 489, V. 1960, D. 5, fl. 11.

⁵⁰ *Gazeta Zyrtare*, nr. 25, Tiranë, 14 shtator 1951, f. 795-800.

emëruar të tyre, të cilët kishin gjithë të drejtat që u jepte pushteti hierarkik mbi klerin nën vartësi të tyre. Kompetencat, detyrat dhe të drejtat buronin nga statuti i kishës katolike, në përputhje me gjithë strukturën e organizimit të saj në rang botëror.

Ndryshe nga tre komunitetet fetare në Shqipëri, sikundër u pohua edhe më sipër, komuniteti katolik e kundërshtoi hapur dekretligjin 743/1949 për entet fetare, i cili aplikonte parimin e një “kishë kombëtare shqiptare”, çka cenonte parimin hierarkik të Kishës Katolike si të tillë. “Të detyroje kishën katolike të pranonte skemën e statutit, - vinte në dukje me zgjuarsi studiuesi G. Cimbalo, - do të thoshte të nxisje rrëmujë, të shtyje drejt dhunës një pjesë të besimtarëve katolikë shqiptarë, për të cilët Selia e Shenjtë ishte simboli mijëra vjeçar i fesë. Për këtë arsye shteti e ftoi Kishën katolike të shtrohej në bisedime për arritjen e një marrëveshjeje që do t’i jepte zgjidhje konfliktit, por, në të njëjtën kohë, shihet se si të bënte për vete, së paku, një pjesë të klerit”.⁵¹

Qeveria këmbëngulte sidomos për emërimin e katër ipeshkvinjve, të cilët duhet të kalonin fillimisht nga dyert e saj dhe mëpastaj t’i dërgoheshin Selisë së Shenjtë për miratim, çka e përmbyste parimin hierarkik që kjo kishë aplikonte në shekuj. Vetë Selia e Shenjtë e rrëzoi propozimin e qeverisë shqiptare duke u shprehur se emërimi i ipeshkëve ishte kompetencë e saj, jo e Kishës Katolike Shqiptare, ca më pak e qeverisë.⁵² Konflikti i shpërthyer e detyroi qeverinë të ndiqte një politikë më dinake e më tinëzare, duke aplikuar diversionin dhe përçarjen. “Drejtesit e klerit nuk do të bëheshin kurrë miqtë e qeverisë dhe të partisë, - shkruante Enver Hoxha në librin e tij “Kur lindi Partia”, - ndërsa besimtarët janë miqtë tanë, por partia duhet të punojë ngadalë dhe me durim për çrrënjosjen e besimit ndaj zotave, fesë dhe kishës”.⁵³

Politika diversioniste dhe përçarëse e PPSH ndaj kastës së lartë të hierarkisë kishtarë katolike në Shqipëri u pa në mënyrë të qartë dhe në votimin e kryer gjatë konferencës së nëntorit të vitit 1950 të komunitetit katolik, ku nga 56 delegatë, 21 votuan pro skemës statuoare të qeverisë. Kjo dëshmohet, ndër të tjera, edhe nga raporti i paraqitur nga ana e qeverisë në Sekretariatën e KQ të Partisë së Punës, në të cilin thuhej konkretisht se “nga puna e bërë nga organet e partisë dhe Sigurimit të

⁵¹ G. Cimbalo, *Pluralizmi i besimit dhe komunitetet fetare ...*, f. 142.

⁵² Z. Simoni, *Persekutimi i kishës katolike në Shqipëri 1944-1990...*, f. 275-276.

⁵³ Enver Hoxha, *Kur lindi Partia*, Tiranë: 8 Nëntori, 1981, f. 159-160.

Shtetit në rrethet me popullsi katolike, është shkaktuar një përçarje në gjerarkët e klerit katolik”.⁵⁴

Neni 13 konsiderohej nga shteti pikërisht si “zemra” apo “thembra e Akilit” për arritjen e marrëveshjes dhe zgjidhjen e mospajtimit. Në artikullimin e tij, sipas projektstatutit të paraqitur nga kisha, kahet qenë diametralisht të kundërt, posaçërisht në mënyrën e emërimit të klerit të lartë. Kisha parashihte që “gjerarkët e kishës katolike (vikarë kapitullarët dhe mitropoliti) zgjidhen nga konferenca e klerit katolik, i parashtrihen Papës për konfirmim dhe pastaj i paraqiten qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë për aprovim, kurse sipas ligjit të komuniteteve fetare, këta gjerarkë, mbasi të zgjidhen nga konferenca e klerit katolik, i paraqiten qeverisë për aprovim dhe pastaj mund të kërkojnë, në rrugë shtetërore, bekimin e Papës”.⁵⁵

Në vend të Papatit si organi më i lartë vendimmarrës i Kishës Katolike Botërore, statuti njohu dhe krijoi një strukturë vendore të re, i quajtur “Episkopati i lartë Katolik” me qendër në Shkodër. Ai merrte përsipër drejtimin fetar dhe administrativ. Kupola e këtij forumi të ri përfaqësohej nga argjipeshkvi i metropolisë së Shkodrës, si tutori më i lartë i gjithë punëve të kishës. Atij i atribuohesh e drejta për komunikime institucionale dhe lidhje marrëveshesh me përmbajtje fetare me forume dhe institucione homologe të vendeve të tjera.

Kompromisi i arritur u shfaq qysh në përcaktimin e përmbajtjes, misionit dhe karakterit të Kishës Katolike Shqiptare, ku thuhej: “Kisha katolike e Shqipërisë ka *karakter kombëtar*, është një person juridik dhe përfshin të gjithë besimtarët katolikë të Shqipërisë. Ajo frymëzohet nga parimet fetare të kishës *botërore* katolike, të themeluar prej Jezus Krishtit, nën *drejtimin fetar të Papës*, trashëgues i pushtetit të apostullit Pjetër. Ajo nuk mban me Papën asnjë lidhje të llojit *organizues, ekonomik apo politik*”.⁵⁶

Kësodore statusi i kishës si person juridik rivlerësohej përmes nocionit politik të “kombëtares”, çka nënkuptonte shkëputjen nga të gjitha marrëdhëniet dhe lidhjet me karakter *organizues, ekonomik apo politik* me Kurien Romake. Ky qe një paradoks, por u pranua nga kisha për të mos zhbërë dhe dëmtuar në mënyrë të pandreqshme funksionet dhe

⁵⁴ *Mbi komunitetet fetare*, Sekretariati i PPSH, vendim nr. 245, datë 22 dhjetor 1950. <http://vargmal.org/dan/2293>. 25.04.2010

⁵⁵ *Po aty*.

⁵⁶ *AQSH*, F. 890, V. 1950, D. 2153, fl. 34.

misionin e saj. Sikurse kuptohet dhe nga vendimi i Sekretariatit të KQ të PPSH, nr. 245, datë 22 dhjetor 1950, në zgjidhjen e këtij konflikti që kërkuar edhe konsulenca juridike e sovjetikëve.⁵⁷ Neni 1 i statutit të kishës katolike në të vërtetë e zhvendoste të drejtën e marrjes së vendimeve brendapërbrenda vendit, duke pranuar e legjitimuar kështu një akt disintegrimi. Kjo krijonte një rreth të mbyllur, vicioz, që do të pasohej nga një hermetizëm insitucional mbytës, teksa propaganda e quante një fitore të madhe.⁵⁸ Falë kësaj formule të sanksionuar nga skema statuore e qeverisë u legjitimua dualiteti i kishës njëherazi edhe kombëtare, edhe pjesë e organizmit katolik botëror e universal. “Pa theksuar dhe shumë ndryshime të tjera, - thekson studiuesi Ajet Shahu, - mund të themi se, krahasuar me statutin e mëparshëm, statuti i ri pësoi një përmbysje të plotë. Kryesorja ishte se ai e bëri kishën katolike shqiptare *autoqefale* dhe legalizoi luftën institucionale të shtetit kundër saj”.⁵⁹ Kompromisi i realizuar, në një farë sensi, ishte zgjidhja e vetme për të shpëtuar tkurrjen e jashtëzakonshme të kishës, pasi sipas Giovanni Cimbalo-s, kjo “u lejonte atyre të ruanin njëfarësoj të mirat e tyre. Është pikërisht kërcënimi i zhveshjes prej të gjitha të mirave, që e shtyn kishën katolike të Shqipërisë të hartojë statutin e vet dhe ky është një tregues i vërtetë i njohjes së qëndrueshmërisë së formave të reja të shtetit”.⁶⁰

Nga këndvështrimi strukturor, në piramidën drejtuese të klerit katolik shqiptar qëndronte argjipeshkvia e Shkodrës, e cila emëronte peshkopët e dioqezave dhe emisarët e tjerë të lartë. Dioqezat ishin në varësi të argjipeshkvisë së Shkodrës dhe administroheshin prej saj, çka përfshinte sigurimin dhe shpërndarjen e të ardhurave dhe benefiteve të tjera.

•
Ndërhyrja e shtetit komunist në “qeverisjen” e komuniteteve fetare përmes statuteve të tyre jo vetëm që cenoi integritetin juridik të tyre, por

⁵⁷ “Për të zgjidhur çështjen e përmbajtjes së nenit 13 të projektstatutit të tretë të kishës katolike, është kërkuar mejtimi, në formë këshillimi, i shokëve sovjetikë.” *Mbi komunitetet fetare*, Sekretariati i PPSH, vendim nr. 245, datë 22 dhjetor 1950. <http://vargmal.org/dan/2293>.

⁵⁸ Ajet Shahu, “Shteti Komunist dhe kisha katolike 1945-1967”, në Konferencën ipeshkvnore të Shqipërisë, *Krishtërimi ndër shqiptarë*, Simpozium ndërkombëtar, Tiranë, 16-19 nëntor 1999, Shkodër: Phoenix, 2000, f. 361.

⁵⁹ Po aty, f. 360.

⁶⁰ G. Cimbalo, *Pluralizmi i besimit dhe komunitetet fetare në Shqipëri...*, f. 148.

në një shumicë nenesh këto statute shprehnin brendi politike në përputhje me regjimin. Ligji i linte shtetit diskrecionin të ndihmonte ose jo komunitetet fetare, gjithë pjesa tjetër e ligjit ishte thelbësisht një listë detyrimesh që komunitetet fetare kishin ndaj shtetit. Në skajin e kundërt me modelin e një shteti teokratik (që synon shkrijen në një të shtetit me fenë) regjimi i PPSH, ndonëse shpallte ngado laicizmin e tij, nuk ndahej aspak nga feja, por praktikisht shrinte pushtetin mbi çdo aspekt me rëndësi në veprimtarinë e komuniteteve fetare. Mbishtresa politike në statute e heq mbulesën formale dhe në nene të caktuara dorashka e angazhimit politik u është përplasur në fytyrë komuniteteve fetare, mjaft të përmendet se në detyrën e edukimit të besimtarëve dhe klerit duhej të mbahej parasysh edhe qëllimi “që të luftoheshin besëtytnitë e vjetra”⁶¹.

Në një kuptim, i përligjur historikisht, statutet qenë shprehje e një kompromisi politik me situatën ku gjendeshin komunitetet fetare, përfshi edhe segmentet e devotshme proqeveritare brenda tyre, duke përcjellë në trajtë juridike statuoare një farë garancie ndaj shtetit komunist, për të ndjekur vijën e tij politike. Ky shtet i ri tashmë kërkonte prej komuniteteve fetare një angazhim të hapur politik, brohorima entuziaste dhe duartrokitje deri në raskapitje, nga të gjithë. Asnjë përjashtim nuk do të tolerohej.

Për t'i zhdukur subjekteve të cilave iu drejtohej ligji, çdo hapësirë për interpretime të “gabuar”, neni 15 i jepte të drejtën qeverisë të pezullonte a shkarkonte cilindo funksionar të akuzuar si i përfshirë në veprimtari antidemokratike, pa qenë qeveria e detyruar të marrë në konsideratë vendimet e organeve drejtuese të komuniteteve fetare.

Cilësimi si “antidemokratik” është përgjithësisht tepër i “kollajtë”, edhe në kohët tona. Kur e ndërftim në kontekstin e një regjimi totalitar, terreni mbi të cilin duhet të ushtronin veprimtarinë e tyre funksionarët fetarë, veçanërisht në raport me organet represive dhe ato të drejtësisë, duket vërtet tepër i rrëshqitshëm. Klauzola të tilla e bënë praktikisht të detyrueshëm përkatësinë e nënkuptuar politike ndaj regjimit si dhe një farë “militantizmi”, i fshehur ky nën termat nacionaliste e populiste. Tashmë klerikët ishin thelbësisht nëpunës të këtij shteti të ri revolucionar, që pasi i keqtrajtoi, i poshtëroi dhe paralizoi, më pak se dy dekada më pas, kur u bind se ishin të parrezikshëm, së fundi do i flakte në rrugë, si krejtësisht të padobishëm.

⁶¹ *Gazeta Zyrtare*, nr. 38, Tiranë, 21 qershor 1950, Dekret nr. 1065, 4.05.1950, neni 11.

Më në fund, duhet pohuar se marrëdhëniet juridike midis komuniteteve fetare dhe shtetit shqiptar, në fillimvitet e regjimit komunist 1945-1949, të shprehura në statutet e tyre gjegjëse, përfaqësojnë dukurinë e trysnisë, dhunës, goditjes diabolike ndaj komuniteteve fetare dhe përshtatjes së statuteve të tyre synimeve të tij politike. Deformimi i kësaj marrëdhënieje i parapriu ngjarjeve tragjike të vitit 1967.

I vetmi krahasim që na vjen ndërmend është vetëm koha kur politika qeveritare e Republikës së re Franceze diktohej nga zelli i zjarrtë antifetar i jakobinëve nën drejtimin e Robespierit.* Por, këto ndërhyrje që rreken të zëvendësojnë dogmat e shenjta dhe Zotin me koncepte ideologjike e politike, për të imponuar kështu mite të reja, kulte të rinj adhurimi, të propaganduara si shpëtimtarë të kombit dhe kujdestarët e rinj të "grigjës sociale", qofshin arsyeja supreme, njeriu i ri i marksizëm-leninizmit etj., besoj se jo rastësisht, përherë kanë dështuar.

S u m m a r y

LEGAL RELATIONSHIP BETWEEN RELIGIOUS COMMUNITIES WITH THE ALBANIAN STATE - STATUTES 1949-1950

The brutal intervention of the communist state in the "governance" of religious communities through their statutes not only violated their legal integrity, but in a number of articles these statutes expressed political brand in accordance with the regime line. The law was essentially a list of obligations that religious communities owed to the state. On the opposite end of the spectrum of a theocratic state (aiming to merge a state into a religious system), the PPSH regime, although proclaiming its secularism everywhere, did not secede at all from religion, but practically extended its power over every important aspect in the activity of religious communities.

The political content of the imposed statutes removes the formal veil and in certain articles the glove of political engagement is slapped in the face of the religious communities, (just to mention the task of the clergy in educating

* Sot në Francë kishat ende lartësohen po njësoj madhështore, ndërkohë që me mbiemrin e Robespierit nuk ka as edhe një pllakatë të vetme, përveçse në periferi të Arresit, vendlindja e tij, ku një garazh për riparimin e makinave ka për pronar një pasardhës të po atij fisi.

people with the aim “to fight the old superstitions”. In a sense, historically justified, the statutes were an expression of a political compromise with the de facto situation of the religious communities, including the pious pro-government segments within them, conveying in statutory legal forms, a kind of extra guarantee for the new communist state, the communities will follow its lines. This new state already demanded from the religious communities an open political commitment, enthusiastic and sincere applause to the point of exhaustion, from everyone. No exceptions would be tolerated.

